

## TÜV NORD CERT

## Standarti ISO 14001:2015

Sistemi i Menaxhimit të  
Mbrojtjes së Mjedisit**Sistemi i Menaxhimit Mjedisor**

Në botën e sotme kur kujdesi për mjedisin merr një vend primar, në menaxhimin aktual të Kompanisë duhet të përfshihen aspekte mjedisore si përcaktues kyç në cilësinë e zhvillimit të saj.

Standardi Ndërkombëtar EN ISO 14001: 2015 flet për kërkesat që duhet të plotësojë Kompania në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit.

Përvoja në aplikimin e Sistemeve të Menaxhimit mjedisor konfirmon se baza e idesë së mbrojtjes së mjedisit është një kuadër i shkëlqyer për zhvillimin inovativ, parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e burimeve natyrore. Ai siguron një kornizë për një pikepamje të strukturuar dhe sistematike për menaxhimin e ndërveprimeve midis organizatës/kompanisë dhe mjedisit. Mjedi është toka, ajri, uji, flora dhe fauna, si dhe njerëzit që jetojnë atje.



Ky standard është gjithashtu në përputhje me sistemet e tjera të menaxhimit.

Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit (EMS) përfshin strukturën organizative, aktivitetet planifikuese, përgjegjësitë, praktikën, procedurat për zhvillimin, zbatimin, arritjen, shqyrtimin, ruajtjen dhe politikën e menaxhimit të mjedisit.

Elementet themelore të SMM(EMS) janë:

- vendimet e marra nga Administrata e Kompanisë mbi nevojën për të implementuar sistemin
- përcaktimi i politikave të menaxhimit të mjedisit
- planifikimi i aktiviteteve
- zbatimi i planifikuar e aktiviteteve të Kompanisë
- vlerësimi i rezultateve
- përmirësim të vazhdueshëm.

Standardi Ndërkombëtar ISO 14001: 2015 është menduar për organizatat që implementojnë, zbatojnë dhe duan të përmirësojnë sistemin EMS dhe duke vepruar në përputhje me politikën e miratuar të këne mundësi të certifikohen nga një organizatë e pavarur e cila të sigurojë që sistemi SMM (EMS) i implementuar të jete në përputhje me kërkesat e Standardit ISO.

ISO 14001: 2015 kërkon të formalizohet në Kompani, Politika Mjedisore e Menaxhimit dhe Objektivat, dhe duke marrë parasysh të gjitha ligjet përkatëse kombëtare që disiplinojnë këtë fushë.

Standardi është i aplikueshëm për të gjitha industritë.

Çertifikata ju merrni pas përfundimit me sukses të procesit të Auditimit me TÜV NORD do të jete e akredituar nga Enti Publik Gjerman i Akreditimit (Dakks).

Dokumentat e Sistemit të Menaxhimit nuk është e nevojshme të përkthehet në një gjuhë të huaj.

## **Elvis Pazaj**

Lead Auditor:

ISO 9001; ISO 14001; ISO 45001

R.A. Soc Resp. ISCC EU/GHG Auditor

**TÜV NORD CERT GmbH**

Systemzertifizierung / System Certification

Am TÜV NORD Bulgaria -TUV NORD GROUP

1005 Tirana,

Albania

**M** +355 (0)692031015

**F** +355 (0)445 31015

**E** [epazaj@tuev-nord.de](mailto:epazaj@tuev-nord.de)